



**VENDIM**

**Nr. 10 Datë 25.01.2012**

**MBI**

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË LIDHJE ME VENDIMIN NR. 147 DATË 07.12.2011, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHEN E TRETE RREGULLATORE” DHE VENDIMIN NR. 148, DATË 07.12.2011, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORE PËR PERIUDHEN E TRETE RREGULLATORE” TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 dhe 16/1 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të ndryshuara, nenit 25 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.01.2012, mbasi analizoi ankimin e paraqitur nga CEZ Shpërndarje sh.a me shkresën nr. 7125/1, datë 26.12.2011, si dhe relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, dhe opinionin e Panelit Rishikues, të krijuar sipas procedurave të parashikuara në marrëveshjen e mbështetjes qeveritare të miratuar me Ligjin Nr. 10126 datë 11.05.2009, “Për Miratimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a”,

**Konstatohet se:**

- Në Ankimin e Cez Shpërndarje sh.a, janë paraqitur në cilësinë e provave të reja rillogaritjet e Bazës së Rregulluar të Aseteve, të dhënat aktuale të raportimit të 11 muhorit 2011, si dhe gabimet matematikore përkatëse,
- Të dhënat shtese të Cez Shpërndarje sh.a, Rekomandimet e Panelit rishikues dhe argumentimet e Grupit të punës të ERE-s që shqyrtoi këtë ankim, dhe rillogaritjet dhe axhustimet përkatëse nuk sjellin asnjë ndryshim në të ardhurat e kërkuara të kompanisë Cez Shpërndarje për periudhën e trete rregullatore

**VENDOSI :**

1. Te pranojë shqyrtimin e kërkesës së CEZ Shpërndarje sh.a, për rishikim të vendimeve të ERE-s nr. 147 datë 07.12.2011, “Për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e trete rregullatore” dhe vendimin nr. 148, datë 07.12.2011, “për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën e trete rregullatore” sipas shkresës së CEZ Shpërndarje sh.a me nr. 7125/1, datë 26.12.2011.
2. Lënien në fuqi të Vendimeve nr. 147 datë 07.12.2011, “Për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e trete rregullatore” dhe vendimin nr. 148, datë 07.12.2011, “për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën e trete rregullatore” të Bordit të Komisionerëve të ERE-s
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**